

Titulli i temës së diplomës Master:	E drejta e qasjes ne dokumente publike dhe zbatimi i kesaj te drejte nga Institucionet e Republikes se Kosoves
Kandidati:	Dafina Leku
Mentori:	Prof.Ass. Dr. Florent Muçaj

ABSTRAKT

“Qasja në dokumentet publike dhe zbatimi i kësaj të drejte nga institucionet e Republikës se Kosovës” është që në rend të parë të njihemi me këtë të drejtë të inkorporuar në të drejtën e lirisë së shprehjes.

Pastaj me anë të këtij punimi jam munduar të paraqes një pasqyrë të legjislacionit vendor , jurisprudencës vendore dhe ndërkombëtare lidhur me të drejtën e qasjes në dokumente publike.

Gjatë hulumtimit e kam parë që kjo temë është aktuale dhe ka për qëllim të informoi gazetarët dhe profesionistët e tjerë të mediave, anëtarët e shoqërisë civile, profesionistët ligjor dhe publikun për zhvillimet ligjore, administrative dhe gjyqësore në fushën e së drejtës. me mjaftë përfitime për shkencën temë e cila është ende e pa trajtuar .Mendoj që pas hulumtimit dhe analizës së kësaj teme do të ofrojë edhe disa shembuj të dokumenteve të cilat janë bërë publike.

Qasja në dokumente publike në vendin tonë është e mbrojtur me ligj edhe pse baza ligjore është mjaft e avancuar për implementimin e ligjit mirëpo në praktike nuk ka shënuar përmirësim të dukshëm edhe pas nxjerrjes së ligjit të ri për qasje në dokumente publike dhe parashikimit me Kushtetutë.

E drejta e qasjes në dokumente publike është një prej të drejtave themelore të njeriut dhe një standard bazë në një vend ku mbizotëron qeverisja demokratike.

E drejta për tu informuar është një e drejtë e rregulluar me kushtetutën e vendit tonë pastaj e parashikuar edhe më një sërë ligjesh të posaçme, duke filluar nga fushë veprimtaria e ligjit në fuqi dhe ligjeve paraprake e deri tek parimet themelore të qasjes në dokumente publike.

Përmes këtij punimi synohet që të njihemi me ligjet, udhëzimet administrative qe na njoftojnë rreth të gjitha procedurave të qasjes në dokumente publike, publikimi dhe format e tij, kërkesat, afatet ligjore të tyre, format e qasjes, shpenzimet e procedurave të qasjes, refuzimet, mjetet juridike, ankesa, pastaj roli dhe rëndësia e Avokatit të Popullit, ripërdorimi dhe kushtet e

ripërdorimit dhe organeve të pavarura mbikëqyrëse, masat për zbatimin e ligjit, raportimet, gjobat e deri tek dispozitat kalimtare dhe perfundimtare.

Në një shtet me demokraci të mirëfilltë qytetarët duhet të kenë mundësinë e qasjes në dokumente publike dhe me çështjet që kanë të bëjnë me të.

Kjo qasje ka për qëllim kryesor fuqizimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve dhe zyrtareve në punën e tyre.

Me anë të kësaj të drejtë i mundësohet qytetarit që të hulumtoj dhe të vë para përgjegjësisë organet e ndryshme të qeverisjes, nga organet e nivelit më të lartë e deri tek zyrat lokale.

Dokumentet që mbajnë institucionet dhe organet shtetërore janë publike përveç atyre informacioneve që janë të kufizuara me ligj, janë sekret shtetërore ose janë informacione të klasifikuara të sigurisë.

Prishtinë, 2023